



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:120658

Datë: 31.10.2024

Numri i dokumentit: 06382990

KPPP.nr. 725/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Gera-Kos” Sh.P.K, me numër unik identifikues 810866361 dhe seli në Fushë Kosovë, rr. “Nëna Terezë”, nr. 277, Apollonia, përfaqësuar sipas autorizimit nga Faton Bërbatovci, avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Inno Home”, Sh.P.K, me numër unik identifikues 811875840 dhe seli në Graçanicë, rr. “Stevana Parica”, nr. 38, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 247/24, i lejuar me datë 02.04.2024, nga Përmbaruesi Privat Rezarta Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 31.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Inno Home”, Sh.P.K, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 247/24, i lejuar me datë 02.04.2024, nga Përmbaruesi Privat Rezarta Metaj.
- II. Urdhri Përmbarimor P.nr. 247/24, i lejuar me datë 02.04.2024, nga Përmbaruesi Privat Rezarta Metaj, MBETET NË FUQI

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditori “Gera-Kos” Sh.P.K., mbi bazën e dokumentit të besueshëm; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 1221, e datës 29.12.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 1213, e datës 27.12.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 1210, e datës 26.12.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 1208, e datës 26.12.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 1200, e datës 22.12.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 1195, e datës 20.12.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 1193, e datës 20.12.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 1191, e datës 19.12.2022; Faturës nr. 22-

ShV01- 001- 1186, e datës 17.12.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 1181, e datës 16.12.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 1178, e datës 15.12.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 1177, e datës 15.12.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 1127, e datës 03.12.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 1115, e datës 30.11.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 1091, e datës 24.11.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 1077, e datës 21.11.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 1068, e datës 18.11.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 1033, e datës 10.11.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 1007, e datës 02.11.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 967, e datës 25.10.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 923, e datës 12.10.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 771, e datës 29.08.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 812, e datës 13.09.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 805, e datës 08.09.2022; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 153, e datës 10.02.2023; Faturës nr. 22-ShV01- 001- 869, e datës 25.08.2023, si dhe; Faturës nr. 22-ShV01- 001-1, e datës 03.01.2023, ka lejuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 247/24, të datës 02.04.2024, me të cilin është urdhëruar debitori “Inno Home” Sh.P.K., që kreditorit t’ia paguaj borxhin e mbetur në lartësi prej EUR 8,718.90, me kamatë prej 8 % duke llogaritur nga dita e arritjes për pagesë, data 03.04.2023, e deri në përmbushjen definitive, shpenzimet e procedurës përmbarimore si dhe shpenzimet për avokat sipas rregullores për tarifatat e avokatëve EUR 104,00.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetim se në faturat e dorëzuara nga kreditori nuk është treguar koha e përmbushjes së detyrimit dhe nuk figuron vula e debitorit, por vetëm nënshkrimi i tij, ndërsa ka shtuar se me asnjë provë nuk është vërtetuar se borxhi sipas faturave është bërë i arritshëm për pagesë dhe se kreditori nuk ka paraqitur deklaratë me shkrim për kërkueshmërinë e borxhit. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin si të bazuar, ndërsa urdhrin përmbarimor ta anuloj.

Përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit në përgjigje në prapësim ka theksuar se e kundërshton prapësimin e debitorit sepse, të gjitha faturat kanë datën e lëshimit të tyre dhe datën e përmbushjes ku si të tilla janë sjellë me dosje origjinale dhe kopje, gjithashtu në lidhje me pretendimet e debitorit se faturat nuk janë vulosur nga debitori, kreditori thekson që në të gjitha faturat e cekura në arsyetim janë nënshkruar nga i njëjti person. Andaj, gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta refuzojë, Urdhrin përmbarimor ta lej në fuqi dhe debitori t’i paguajë shpenzimet për përgjigje në prapësim në shumë prej EUR 156.00.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden

në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.

Gjykata vlerëson se përmbartuesi privat ka lejuar urdhrin përmbartimor mbi bazën e dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturave të përshkruara si në hyrje të arsyetimit të këtij aktvendimi, fatura këto të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Poashtu, gjykata gjen se e njëjta faturë është lëshuar me rregull nga ana e kreditorit, ndërsa është pranuar dhe nënshkruar nga debitori.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbartimor, i plotëson kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta i është bashkëngjitur propozimit për përmbartim.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e Urdhrit përmbartimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 725/24, datë 31.10.2024

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.